



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:200939

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05634894

PA1.nr.914/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.M, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK, dhe L.A për shkak të veprës penale, lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1 nën par. 1.3 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.150/21 të datës 04.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.150/21 të dt.04.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.150/21 të dt.05.05.2023, të akuzuarin, L.M e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me kusht, gjobë në shumën njëqind e pesëdhjetë (150) euro, dhe i cili dënim nuk do të zbatohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë të re penale të peshës së njëjtë ose të ngjashme brenda një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi. Obligohet që në emër të procedurës penale në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ta paguajë shumën prej njëzet (20) eurosh. Të akuzuarit L.A për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1 nën par. 1.3 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me kusht, burgim

në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh dhe cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë të re penale të së njëjtës ashpërsi ose të ngjashme brenda 1 (një) viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij gjykimi. Obligohet që në emër të gjykatës në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ta paguajë shumën prej njëzet (20) eurosh. Marrin përsipër të paguajnë individualisht një pjesë të shumës totale prej 20 euro, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjekësor, në vlerë prej dhjetë (10) euro secili, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e përfundimit të këtij gjykimi. I dëmtuari S.N nga fshati ..., komuna e Graçanicës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar përkitazi me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarve L.M dhe L.A dhe të njëjtëve t'iu shqiptojë dënim më të lartë dhe atë në proporcion me peshën e veprës penale të kryer.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.950/2023 të datës 27.07.2023, ka propozuar që të aprovohet ankesa Prokurorit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve ti shqiptohet një dënim më i lartë dhe atë në proporcion me peshën e veprës penale të kryer.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është atakuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarës e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me pretendimet se gjykata e gjykata e shkallës së parë nuk ka shqiptuar një dënim të drejtë ndaj të akuzuarve, në proporcion me veprën penale të kryer dhe të mirën juridike të dëmtuar, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar është kundërthënës nga dispozitivi e deri te shqiptimi i dënimin dhe nuk përmban të gjitha rrethanat të cilat janë parapa në nenin 69 të KPRK-së e që kanë ndikuar në shqiptimin e lartësisë së dënimin. Konsideron se dënimi i shqiptuar nuk është i drejtë dhe në proporcion me veprën e kryer penale, për shkak se rrethanat lehtësuese të marra parasysh nga gjykata, në mënyrë disproporcionale kanë ndikuar në matjen e një dënimi aq të butë ndaj të akuzuarve, konsiderojmë se me dënime të tilla nuk do të parandalohet kryerja e veprave penale dhe se me këto dënime nuk do të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit penal i përcaktuar me nenin 38 të KPRK-ës, dhe

se nga gjykata gabimisht janë interpretuar dispozita e nenit 69 të KPRK-së, prandaj të pandehurve iu është shqiptuar një dënim jo proporcional me veprat e kryera dhe ky nuk shprehë satisfaksion për të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të ulët për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit në pajtim me dispozitat e nenit 69 të KPRK-së, pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, kanë pasur sjellje të mirë gjatë seancës, se kanë premtuar se nuk do të bien ndesh me ligjin në të ardhmen, si dhe faktin se deri tani nuk kanë pasur konflikt me ligjin.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e prokurorit për ti shqiptuar një dënim më të lart. Të gjitha këto rrethana, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimit, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjeneralë, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitivin e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.914/2023, më datë 24.04.2024

Procesmbajtësja,
Ilmije Rexhepi Beqiri

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Ferit Osmani

Abdullah Ahmeti